

**GJYKATA E APELIT
PRISHTINË**

NË EMËR TË POPULLIT

Numri i lëndës: PAKR 158/15

Data: 5 prill 2016

Gjykata Themelore: Prizren, P. Nr. 272/13

Origjinali: në anglisht

Gjykata e Apelit, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën e Apelit Radostin Petrov, kryetar dhe gjyqtar raportues, gjyqtari vendor i Gjykatës së Apelit Xhevdet Abazi dhe gjyqtari i EULEX-it në Gjykatën e Apelit Roman Raab, anëtarë të kolegjit, të asistuar nga Alan Vasak, zyrtar ligjor i EULEX-it, në cilësinë e procesmbajtësit,

Në lëndën lidhur me të pandehurit:

N.U.;

O.J.;

S.M.;

S.S.;

T.M.;

E.A.;

F.B.;

R.R.;

H.B.;

G.G.;

Të akuzuar me aktakuzën e Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (tutje në tekst “PSRK”) PPS. Nr.: 253/09, të datës 19 korrik 2012 dhe me aktakuzën e ndryshuar të datës 22 janar 2014, për këto vepra penale:

Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me Nenin 346 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (tutje “KPPK”) *në lidhje me O.J., E.A., F.B., S.M., S.S., T.M. dhe R.R.*;

Ndihmë në nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së, lidhur me Nenin 25 KPPK-së *në lidhje me H.B. dhe G.G.*;

Nxitja e personit tjetër për nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së, lidhur me Nenin 24 të KPPK-së *në lidhje me N.U.*;

të gjykuar në shkallën e parë nga Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykimin P.nr. 272/13, të datës 9 shtator 2014, me të cilin:

I pandehuri N.U. u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të ricilësuar si Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në bashkëkryerje, në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së, në lidhje me Nenin 23 të KPPK-së. I pandehuri N.U. u dënua me burgim me kusht për 2 vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprën tjetër penale në një periudhë 2 (dy) vjeçare, si dhe me dënim plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej tri (3) viteve.

E pandehura O.J. u shpall fajtoreshë për kryerjen e veprës penale Ndihmë për nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së. E pandehura O.J. u dënua me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen ndonjë veprën tjetër penale brenda periudhës kohore prej 2 (dy) viteve, si dhe me dënim plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej dy (2) viteve.

E pandehura S.M. u shpall fajtoreshë për kryerjen e veprës penale Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së. E pandehura S.M. u dënua me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen ndonjë veprën tjetër penale brenda periudhës kohore prej 2 (dy) viteve, si dhe me dënimin plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej dy (2) viteve.

E pandehura S.S. u shpall fajtoreshë për kryerjen e veprës penale Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së. E pandehura S.S. u dënua me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen ndonjë veprën tjetër penale brenda

periudhës kohore prej 2 (dy) viteve, si dhe me dënimin plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej dy (2) viteve.

I pandehuri T.M. u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së. I pandehuri T.M. u dënua me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej 2 (dy) viteve, si dhe me dënimin plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej dy (2) viteve.

Të pandehurit E.A., F.B. dhe R.R. u shpallën fajtorë për kryerjen e veprës penale Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së. Të pandehurit E.A., F.B. dhe R.R. u dënuan me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej 2 (dy) viteve, si dhe me dënimin plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej dy (2) viteve.

E pandehura H.B. u shpall fajtoare për kryerjen e veprës penale Ndihmë në nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, në kundërshtim me Nenin 346 të KPPK-së, lidhur me Nenin 25 KPPK-së. E pandehura H.B. u dënua me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej 2 (dy) viteve, si dhe me dënimin plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej dy (2) viteve.

I pandehuri G.G. u shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të ricilësuar Falsifikim i dokumenteve, në kundërshtim me Nenin 332 të KPPK-së. I pandehuri G.G. u dënua me dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale brenda periudhës kohore prej 2 (dy) viteve, si dhe me dënimin plotësues Ndalim i ushtrimit të profesionit, aktiviteteve apo detyrës për një periudhë prej dy (2) viteve.

duke i shqyrtuar ankesat e parashtruara nga

PSRK-ja,

avokati mbrojtës Tahir Rrecaj për të pandehurin N.U.,
e pandehura O.J.,
avokati mbrojtës Zivojin Jokanovic për të pandehurën O.J.,
avokati mbrojtës Visar Vehapi për të pandehurën S.M.,
e pandehura S.S.,
i pandehuri T.M.,
të pandehurit E.A. dhe F.B.,
avokati mbrojtës Shefki Sylaj për të pandehurin R.R.,

avokati mbrojtës Musa Dragusha për të pandehurën H.B.,
avokati mbrojtës Qerim Meta për të pandehurin G.G.,

pasi janë shqyrtuar përgjigjet në ankesa,

pasi është shqyrtuar mendimi i Prokurorisë së Apelit,

pasi është mbajtur seanca publike nga Gjykata e Apelit më 30 dhe 31 mars 2016,

pasi është mbajtur këshillimi dhe votimi më datën 5 prill 2016,

duke vepruar në përputhje me nenet 389, 390, 394, 398 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (më tej në tekst si "KPP"),

me shumicë votash nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

Pranohen në mënyrë të pjesshme ankesa e avokatit mbrojtës Zivojin Jokanovic, për të pandehurën O.J. si dhe ankesa e ushtruar nga e pandehura O.J. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13, të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se nuk mund të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm dashja e të pandehurës për të fituar dobi të kundërligjshme pasurore, ndërsa dënimi i shqiptuar plotësues është tejet i paqartë. Pjesa tjetër e ankesës hidhet poshtë si e pabazuar, ndërsa dënimi i të pandehurës vërtetohet.

Pranohet në mënyrë të pjesshme ankesa e mbrojtësit Visar Vehapi për të pandehurën S.M., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13, të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se nuk mund të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm dashja e të pandehurës për të fituar dobi të kundërligjshme pasurore, ndërsa dënimi i shqiptuar plotësues është tejet i paqartë. Pjesa tjetër e ankesës hidhet poshtë si e pabazuar, ndërsa dënimi i të pandehurës vërtetohet.

Pranohet në mënyrë të pjesshme ankesa e të pandehurës S.S., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13, të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se nuk mund të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm dashja e të pandehurës për të fituar dobi të kundërligjshme pasurore, ndërsa dënimi i shqiptuar plotësues është tejet i paqartë. Pjesa tjetër e ankesës hidhet poshtë si e pabazuar, ndërsa dënimi i të pandehurës vërtetohet.

Pranohet në mënyrë të pjesshme ankesa e të pandehurit T.M., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13, të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se nuk mund të provohet përtej dyshimit të arsyeshëm dashja e të pandehurit për të fituar dobi të kundërligjshme pasurore, ndërsa dënimi i shqiptuar plotësues është tejet i paqartë. Pjesa tjetër e ankesës hidhet poshtë si e pabazuar, ndërsa dënimi i të pandehurit vërtetohet.

Pranohet në mënyrë të pjesshme ankesa e avokatit mbrojtës Musa Dragusha, për të pandehurën H.B. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13 të datës 9 shtator 2014, në pjesën ku dënimi i shqiptuar plotësues është tejet i paqartë. Pjesa tjetër e ankesës hidhet poshtë si e pabazuar, ndërsa dënimi i të pandehurës vërtetohet.

Pranohet ankesa e të pandehurve E.A. dhe F.B., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13 të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se të pandehurit E.A. dhe F.B. shfajësohen për Pikën 1, përkatësisht për Nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore.

Pranohet ankesa e avokatit mbrojtës Shefki Syla për të pandehurin R.R. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13 të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se i pandehuri R.R. shfajësohet për Pikën 1, përkatësisht për Nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore.

Pranohet ankesa e avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj, për të pandehurin N.U., kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13 të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se i pandehuri N.U. shfajësohet për Pikën 3, përkatësisht Nxitje e personit tjetër për nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, e ricilësuar nga Gjykata Themelore si Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore në bashkëkryerje.

Pranohet ankesa e avokatit mbrojtës Qerim Metaj për të pandehurin G.G. kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13 të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se i pandehuri G.G. shfajësohet për Pikën 2, përkatësisht për Ndhimë në nxjerrje të kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, e ricilësuar nga Gjykata Themelore si Falsifikim i Dokumenteve.

Pranohet pjesërisht ankesa e Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13 të datës 9 shtator 2014, lidhur me atë se dënimi i shqiptuar plotësues është tejet i paqartë. Pjesa tjetër e ankesës refuzohet si e pabazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prizrenit P.nr. 272/13 i datës 9 shtator 2014, ndryshohet si në vijim:

Në lidhje me shfajësimin e të pandehurve N.U., E.A., F.B., R.R. dhe G.G.

Në pajtim me Nenin 364, paragrafin 3, të KPK-së, i pandehuri N.U. shfajësohet për Pikën 3, Nxitja e personit tjetër për nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve

gjqësore, sepse nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar.

Në pajtim me Nenin 364, paragrafin 3, të KPP-së, të pandehurit E.A., F.B. dhe R.R. shfajësohen për Pikën 1 Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, sepse nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kanë kryer veprën penale me të cilën janë ngarkuar.

Në pajtim me Nenin 364, paragrafin 3, të KPP-së, i pandehuri G.G. shfajësohet për Pikën 2, Ndhmë në nxjerrjen e kundërligjshme të vendimeve gjyqësore, sepse nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri ka kryer veprën penale me të cilën është ngarkuar.

Në lidhje me dënimin e të pandehurve O.J., S.M., S.S. dhe T.M.

Të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M. kanë kryer veprën penale Nxjerrje e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore me qëllim që t'i shkaktojnë dëm personit tjetër.

Në lidhje me dënimin plotësues kundër të pandehurve O.J., S.M., S.S., T.M. dhe H.B.

Në pajtim me Nenin 57, paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, të pandehurve O.J., S.M., S.S., T.M. si dhe H.B. iu ndalohet ushtrimi i profesionit, aktivitetëve apo detyrës gjyqësore për një periudhë prej 2 (dy) viteve, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së Aktgjykimit.

Vërtetohet pjesa tjetër e aktgjykimit të kundërshtuar.

ARSYETIM

I. HISTORIKU I PROCEDURËS NË FJALË

Më 27 korrik 2012, PSRK-ja ka ngritur aktakuzën PPS 253/09 të datës 19 korrik 2012.

Seancat për konfirmim janë mbajtur më 30 gusht 2012, 24 shtator 2012, 18 tetor 2012 dhe më 2 nëntor 2012. Më 24 shtator 2012, të pandehurit F.B. dhe T.M. janë ndarë nga procedura në fjalë. Megjithatë, procedura lidhur me T.M.in është ribashkuar më 18 tetor 2012.

Aktakuza u hodh poshtë duke u bazuar në një aktvendim të lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake më 27 dhjetor 2012. Me këtë rast u pushua procedura kundër të gjithë të pandehurve (duke përjashtuar palën e ndarë nga procedura F.B.).

Prokurori special paraqiti ankesë kundër aktvendimit mbi hedhjen poshtë të aktakuzës. Me një aktvendim të datës 17 prill 2013, Gjykata e Apelit e pranoi pjesërisht ankesën e prokurorit special dhe vendosi që aktakuza të mbetet e vlefshme, duke i bërë ndryshimet. Aktakuza është hedhur poshtë për të gjithë të pandehurit në pjesën ku i referohej cilësimit ligjor Keqpërdorim i pozitës zyrtare.

Më 22 gusht 2013, kryetari i atëhershëm i trupit gjykues, me kërkesë të prokurorit special, e ribashkoi lëndën e të pandehurit F.B. me 9 të pandehurit e tjerë të akuzuar me aktakuzën PPS 253/09. Aktakuza kundër tij u konfirmua nga kryetari i trupit gjykues me një aktvendim të datës 5 dhjetor 2013, i cili u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit.

Aktakuza e ndryshuar është ngritur më 22 janar 2014.

Seancat e shqyrtimit kryesor janë mbajtur më 21 dhe 23 janar 2014, më 5, 18, 20, 24, 25 e 26 shkurt 2014, më 12 mars 2014, më 7 prill 2014, më 19 maj 2014, më 18 dhe 20 qershor 2014, më 29, 30 dhe 31 korrik 2014, si dhe më 3 dhe 4 shtator 2014.

Dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është shpallur më 9 shtator 2014.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua PSRK-së më 15 dhjetor 2014. PSRK-ja ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar më 24 dhjetor 2014.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurit N.U. më 17 dhjetor 2014 dhe mbrojtësit të tij Tahir Rrecaj më 15 dhjetor 2014. I pandehuri, përmes avokatit të tij, ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar më 29 dhjetor 2014.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurës O.J. më 23 janar 2015 dhe avokatit të saj mbrojtës Zivojin Jkanovic më 16 dhjetor 2014. Avokati mbrojtës Zivojin Jkanovic, në emër të të pandehurës, më 30 dhjetor 2014 ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar. Edhe vet e pandehura gjithashtu ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar më 29 dhjetor 2014.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurës S.M. më 18 dhjetor 2014 si dhe avokatit të saj mbrojtës Visar Vehapi më 15 dhjetor 2014. E pandehura, përmes avokatit të saj mbrojtës, me datë 29 dhjetor 2014 ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurës S.S. më 17 dhjetor 2014. Më 24 dhjetor 2014, e pandehura ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurit T.M. më 17 dhjetor 2014. Më 5 janar 2015, i pandehuri ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurit F.B. më 17 dhjetor 2014, ndërsa të pandehurit E.A. më 19 dhjetor 2014. Të pandehurit E.A. dhe F.B. ushtruan ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar më 5 janar 2015.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurit R.R. më 17 dhjetor 2014 dhe avokatit të tij mbrojtës Shefki Sylaj më 18 dhjetor 2014. Përmes avokatit mbrojtës, i pandehuri ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar më 5 janar 2015.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurës H.B. më 18 dhjetor 2014 dhe mbrojtësit të saj, avokatit Musa Dragusha më 15 dhjetor 2014. Përmes avokatit të saj, e pandehura, më 26 dhjetor 2014 ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar.

Aktgjykimi në formë të shkruar iu dorëzua të pandehurit G.G. më 17 dhjetor 2014 dhe avokatit të tij mbrojtës Qerim Metaj më 15 dhjetor 2014. Përmes avokatit mbrojtës, i pandehuri ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të kundërshtuar më 5 janar 2015.

Avokati mbrojtës Visar Vehapi për të pandehurën S.M., e pandehura S.S. dhe i pandehuri G.G., parashtruan përgjigje në ankesën e prokurorisë.

Prokuroria nuk parashtrroi përgjigje në ankesë.

Më 30 mars 2015, lënda iu transferua Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi ankesa.

Më 7 korrik 2015, prokurori i apelit parashtrroi propozimin e tij.

Seanca e Kolegjit të Gjykatës së Apelit janë mbajtur më 30 dhe 31 mars 2016 me praninë e të pandehurve N.U., O.J., E.A., S.S., R.R., T.M., H.B. dhe G.G., avokatëve mbrojtës Tahir Rrecaj (i cili ka qenë i pranishëm vetëm 30 mars 2016), Zivojin Jokanovic, Visar Vehapi (i pranishëm vetëm më 30 mars 2016), Musa Dragusha dhe Qerim Meta, përfaqësuesit të palës së dëmtuar A.H. dhe prokurorit të apelit Lars Agren.

Kolegji mbajti këshillimin dhe votimin më 5 prill 2016.

II. ÇËSHTJET PRELIMINARE

A. Ligji i zbatueshëm në këtë lëndë

a. Ligji i Procedurës

Më 1 janar 2013, në Kosovë hyri në fuqi ligji i ri i procedurës, Kodi i Procedurës Penale, Ligji Nr. 04/L-123. Ky kod shfuqizoi Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës që ishte më parë. Neni 541 i Kodit të tanishëm të Procedurës Penale parasheh që procedura penale, në të

cilën aktakuza është ngritur por nuk është konfirmuar para hyrjes në fuqi të kodit të tanishëm, nuk duhet të konfirmohet sipas dispozitave të Kodit që ka qenë në fuqi gjatë kohës kur është ngritur aktakuza, por do të procedohet sipas dispozitave të Kodit të tanishëm. Aktakuza në këtë rast u konfirmua pas hyrjes në fuqi të Kodit të tanishëm. Ashtu siç është përcaktuar në mënyrë të drejtë edhe nga Gjykata Themelore, ligji i aplikueshëm procedural në këtë rast është Kodi i tanishëm i Procedurës Penale. Gjykata e Apelit zhvillon procedurën në mënyrë përkatëse në përputhje me Kodin e tanishëm të Procedurës Penale.

b. Ligji material

Në pajtim me Nenin 3, paragrafi 1, të Kodit të tanishëm Penal, Ligji 04/L-082 i vitit 2012 (i cili hyri në fuqi më 1 janar 2013), ndaj kryerësit të veprës do të zbatohet ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale ndaj kryesit të veprës. Në pajtim me paragrafin 2 të nenit të lartpërmendur, në rast të ndonjë ndryshimi të ligjit që aplikohet në një rast të caktuar para vendimit përfundimtar, duhet të aplikohet ligji që është më i favorshëm për kryesin e veprës. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata Themelore me të drejtë ka aplikuar kodin e mëparshëm penal, Kodin e Përkohshëm Penal të Republikës së Kosovës. Kësisoj, edhe Kolegji gjithashtu do ta aplikojë këtë version të kodit penal.

B. Kompetenca

Në pajtim me nenin 121, paragrafin 1, të KPP-së kolegji ka rishikuar kompetencat e tij dhe pasi që nuk është paraqitur asnjë vërejtje formale nga palët kolegjit do t'i mjaftojë si në vijim. Në pajtim me Ligjin për Gjykatat dhe Ligji mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – Ligji nr. 03/L-053 i ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-273 dhe i sqaruar nëpërmes Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it, Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014, kolegji konstaton që EULEX-i ka kompetencë ndaj lëndës dhe që kolegji është kompetent që të vendos për lëndën përkatëse në përbërje të një gjyqtari vendor dhe dy gjyqtarëve të EULEX-it.

C. Pranueshmëria e ankesave

Të gjitha ankesat janë të pranueshme. Ankesat janë parashtruar nga personat e autorizuar dhe përmbajnë të gjitha informatat tjera relevante në pajtim me nenin 382 të KPP-së. Ankesat janë parashtruar brenda afatit 15 ditor në pajtim me nenin 380 (1) të KPP-së.

III. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa e PSRK-së

Më 24 dhjetor 2014 PSRK-ja ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore dhe kërkon nga Gjykata e Apelit të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar në pjesën që vijon:

Të rishikojë dënimet e shqiptuara për secilin të pandehur dhe t'i shqiptojë dënimet me burgim të menjëhershëm (neni 383 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, dhe neni 387, paragrafi 1, KPP-së);

Të konstatojë që shfajësimi i G.G.t për veprën e Ndhmës në Nxjerrjen e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore në kundërshtim me nenet 346 dhe 25 të KPP-së ishte vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe të vendosë që akuza është vërtetuar kundër të pandehurit dhe të vendosë që materiali (masat e fshehta) i deklaruar i papranueshëm gjatë Shqyrtimit Gjyqësor të jetë i pranueshëm kundër të pandehurit G.G. (neni 383 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 dhe neni 386, paragrafi 1, KPP-së);

Të vendosë që shpallja fajtor kundër të pandehurit G.G. për veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve në kundërshtim me nenin 332 të KPP-së ka qenë shkelje e ligjit penal (neni 383 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 dhe neni 385, paragrafi 1.3, i KPP-së).

Sa i përket vendimit mbi sanksionet penale dhe dënimeve plotësuese PSRK-ja pretendon se: Gjykata Themelore ka dështuar të vlerësojë saktë ndëshkimin ose vërejtjen gjyqësore sa i përket të gjitha rrethanave relevante. Dënimet e shqiptuara janë shumë të buta dhe nuk pasqyrojnë siç duhet peshën e sjelljes kriminale, rrethanat rënduese dhe ato lehtësuese.

Dënimi ndaj të pandehurve të cilët ishin të përfshirë më rëndë në përsëritjen e veprës penale është dashur të jetë paraburgimi i menjëhershëm me kohëzgjatje të mjaftueshme ashtu që dënimi të shënojë peshën e kryerjes së veprës penale të pandehurit e këtij profili të lartë dhe të shërbejë si parandalim për të gjithë kryerësit potencialë në të ardhmen, të cilët do të mund të përgatiteshin të veprojnë në mënyrë të ngjashme.

Sa i përket përcaktimit të gjendjes faktike, PSRK pohon që Gjykata Themelore ka bërë një numër të vërtetimeve që janë të gabuara dhe jo të plota lidhur me të pandehurin G.G.. Ka fakte të mjaftueshme që i pandehuri G.G. kishte qëllim kriminal që të kryej veprën penale Ndhmë në Nxjerrjen e Kundërligjshme të Vendimeve Gjyqësore në kundërshtim me nenet 346 dhe 25 të KPP-së.

Për më tepër, PSRK-ja pohon që provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor lidhur me bisedimet e fshehta që janë mbajtur më 20 shtator 2013 në mes të G.G.t dhe K.U. në mënyrë të gabuar janë deklaruar si të papranueshme nga Gjykata Themelore.

Sa i përket veprës penale të Falsifikimit të Dokumenteve, PSRK-ja pretendon që parashkrimi në ndjekjen penale për këtë vepër tashmë ka kaluar në pajtim me nenin 90, paragrafi 1 dhe 6 të KPP-së.

B. Ankesa e avokatit mbrojtës Tahir Rrecaj për të pandehurin N.U.

Avokati mbrojtës Tahir Rrecaj në emër të pandehurit N.U. ka parashtruar ankesë më 30 dhjetor 2014 mbi këto baza:

Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale (neni 381, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11, lidhur me nenin 370, paragrafit 6 dhe 7 dhe paragrafit 2, nën-paragrafit 1 dhe 2 të KPP-së);

Shkelje e ligjit penal (neni 385, paragrafit 1, nën-paragrafit 1 të KPP-së);

Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 386, paragrafi 2 dhe 3, të KPP-së).

Mbrojtja propozon që Gjykata e Apelit të miratojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që i pandehuri N.U. të shfajësohet për të gjitha akuzat ose të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe t'ia kthejë lëndën Gjykatës Themelore për rigjykim.

Mbrojtja pohon që Gjykata Themelore ka shkelur të drejtat e pandehurit për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe kjo paraqet shkelje të nenit 369, paragrafi 1, i lidhur me nenin 185, paragrafi 2 të KPP-së dhe shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe brenda periudhës së arsyeshme kohore të garantuar me nenin 5, paragrafit 1 të KPP-së dhe nenit 6.1 ECHR dhe nenit 31, paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Aktgjykimi i kundërshtuar është shpallur më 9 shtator 2014 ndërsa aktgjykimi me shkrim i është dorëzuar avokatit mbrojtës më 15 dhjetor 2014, më tepër se 3 (tre) muaj pas shpalljes së tij.

Për më tepër, mbrojtja pretendon që dispozitivi i aktgjyimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm dhe kontradiktor lidhur me përmbajtjen dhe arsyetimin e aktgjyimit. Nuk është dhënë arsyetim i qartë për faktet vendimtare ndërsa arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kontradiktore. Sa i përket fakteve vendimtare gjithashtu ka kontradikta në mes të arsyetimit, shkresave të lëndës dhe procesverbalit për deklaratat që janë dhënë në procedurë dhe në vet procesverbalin.

Gjithashtu pjesa e arsyetimit të aktgjyimit nuk i adreson drejtë argumentet e mbrojtjes të paraqitura gjatë fjalës përfundimtare. Gjykata Themelore dështoi të vlerësojë me saktësi provat kontradiktore dhe dështoi të jap arsyet e qarta lidhur me vlerësimin e provave.

Për më tepër, mbrojtja pretendon që i pandehuri ka të drejtë kushtetuese për vendim të justifikueshëm në mënyrë koherente. Mbrojtja gjithashtu pretendon që dispozitivi dhe pjesa e arsyetimit kanë dështuar të përshkruajnë se cilat veprime fajësuese i ka ndërmarrë i pandehuri që të konsiderohet si bashkëkryerës.

Veç kësaj, pasi që i pandehuri nuk është cilësuar si Gjyqtar, gjyqtar porotë ose gjyqtari për kundërvajtje, që është element i nenit 346 të KPP-së, ai nuk mund të fajësohet nga neni 346 i KPP-së.

Gjithashtu, Gjykata Themelore ka dështuar të vërtetojë se çka ka qenë përfitimi material dhe si do të duhej të arrihej ai përfitim.

Për më tepër, i pandehuri nuk ka pasur kurrfarë përfshirje në cilëndo prej veprave penale që përshijnë NPSH KBI "Kosovo Export" dhe AKM-në.

Gjykata Themelore në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike. Fakti i dukshëm Vetë fakti që i pandehuri caktoi lëndë të caktuara nuk përbën qëllim për vepër penale. Ai dukshëm ka vepruar siç është dashur të veprojë si kryetar i Gjykatës Komunale në Prishtinë. Lidhur me lëndët serbe, këto lëndë i janë caktuar dukshëm gjyqtarëve serbë me qëllim të shmangies së problemeve logjistike me përkthyes. Sa i përket lëndëve tjera, këto ndonjëherë janë caktuar duke marr parasysh lëndët e mbetura dhe të mbingarkesës e gjyqtarëve të caktuar.

Megjithatë, të gjitha caktimet e lëndëve ishin në pajtim të plotë me procedurat e sistemit gjyqësorë .

Mbrojtja pohon që Gjykata Themelore prima facie ka vlerësuar provat në mënyrë përzgjedhëse dhe të pjesshme, duke i konsideruar provat fajësuese dhe kështu duke shkelur të drejtën e barazisë së armëve.

Gjithashtu, mbrojtja pohon që i pandehuri në mënyrë të vazhdueshme ka respektuar pavarësinë e gjithë gjyqtarëve dhe vendimmarrjet e tyre. Prandaj, i pandehuri nuk është përfshirë në asnjë aktgjykim që kanë nxjerr gjyqtarët tjerë dhe gjithashtu ai nuk ka mundur t'iu thotë atyre çfarë të vendosin. Të gjithë gjyqtarët ishin të vetëdijshëm për Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12 dhe 2002/13 prandaj edhe i pandehuri nuk merr kurrfarë përgjegjësie për çfarëdo interpretimi të mundshëm të gabuar të këtyre rregulloreve prej gjyqtarëve tjerë.

Mbrojtja pohon që Gjykata Themelore ka dështuar të vlerësojë letrat e shumta të AKM-së të cilat e konfirmojnë pafajësinë e të pandehurit.

Mbrojtja pretendon që Gjykata Themelore në mënyrë përzgjedhëse dhe të gabuar ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve të caktuar në dëm të të pandehurit.

Sa i përket korigjimit të aktgjykimit C. nr. 2333/05 të datës 15 maj 2007, mbrojtja pretendon që kjo ishte dukshëm korigjim teknik dhe jo ndryshim substancial për shkak të mungesës së gjyqtarit. Korigjimët e tilla ndodhin shumë shpesh dhe nuk përbëjnë shkelje ligjore.

Mbrojtja pretendon që shkelja e dispozitave ligjore lidhur me kompetencën e gjykatës nuk mund të konsiderohet si element i veprës penale, pasi që kjo shkelje mund të korigjohet me mjetet juridike.

Edhe në qoftë se i pandehuri ka bërë shkelje të procedurës së caktimit të lëndëve, kjo do të ishte thjeshtë çështje e masave disiplinore dhe pa dyshim nuk mund të përbëjë vepër penale. Përveç kësaj, KGJK-ja në mënyrë të rregullt ka rishikuar punën e gjyqtarëve dhe kurrë nuk është gjetur ndonjë shkelje. As Inspeksioni Disiplinor nuk ka gjetur asnjë shkelje.

Shtojcë

Më 24 dhjetor 2015 mbrojtja parashtrroi plotësim në ankesë me prova të reja.

I pandehuri ka dorëzuar një model të aktvendimit mbi caktimin e detyrave të gjyqtarëve dhe personelit ndihmës të gjykatës, AGJ. nr. 50/2005 të datës 31 janar 2005 dhe Përgjigjen e Gjykatës Themelore të Prishtinës, GJA nr. 1040/15 të datës 15 dhjetor 2005 së bashku me 2 tabela të caktimit të lëndëve gjyqtarëve në degën civile të vitit 2003. Kjo vërteton se procedura lidhur me mënyrën e caktimit të lëndëve e zbatuar nga kryetari i Gjykatës Komunale në Prishtinë, i pandehuri N.U. është në pajtim me Vendimin e Asamblesë së Gjyqtarëve të gjykatës përkatëse.

C. Ankesa e avokatit mbrojtës Zhivojin Jkanoviq për të pandehurën O.J.

Më 30 dhjetor 2014, avokati mbrojtës Zhivojin Jokanovic në emër të pandehurës O.J. ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë mbi bazë të:

Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 i KPP-së);
Shkeljes së ligjit penal (neni 385 i KPP-së);
Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 386 i KPP-së);
Vendimi për sanksionin penal, dënimi shtesë (neni 387 i KPP-së).

Mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit që të miratojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që e pandehura O.J. të shfajësohet nga të gjitha akuzat ose të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe të kthejë lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim.

Mbrojtja pretendon që dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, kontradiktor në arsyetim dhe në gjendjen faktike dhe nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare. Gjithashtu edhe pjesa e arsyetimit të aktgjykimit është kontradiktore dhe provat janë vlerësuar gabimisht. Gjykata Themelore ka nxjerr përfundime jo të sakta bazuar në prova të papranueshme. Fushëveprimi i dëmit dhe fushëveprimi i përfitimit material gjithashtu nuk janë shpjeguar me asnjë provë, e as nuk është provuar kjo.

Për më tepër aktgjykimi i kundërshtuar është i paqartë pasi që i pandehuri N.U. është dënuar për bashkëkryerje përderisa e pandehura O.J. megjithatë nuk është dënuar për bashkëkryerje.

Përveç kësaj mbrojtja pretendon që përndjekja e të pandehurit pengon paanësinë dhe pavarësinë e gjyqtarëve si tërësi.

Gjykata themelore nuk i ka vlerësuar të gjitha provat si duhet dhe për më tepër gabimisht i ka vënë theksin provave fajësuese, përderisa në tërësi nuk ka prova të mjaftueshme që vërtetojnë se e pandehura është fajtores përtej dyshimit të arsyeshëm. Mbrojtja gjithashtu pretendon që veprimet e bëra nga e pandehura nuk përbëjnë veprë penale. E pandehura nuk ka nxjerrë vendime jologjore dhe as që është dëshmuar se ka pasur qëllim të përfitimit material. Gjithashtu asnjë dëshmi nuk është paraqitur për çfarëdo dëmi të shkaktuar sa i përket dhënies së tokës. Për më tepër mbrojtja pretendon që veçimi i të pandehurve në këtë lëndë është arbitrar pasi që gjyqtarët tjerë kanë bërë të njëjtën gjë mirëpo asnjëri prej tyre nuk është ndjekur penalisht.

Mbrojtja pretendon që gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë. Deklaratat e dëshmitarit konfirmojnë pozitën e të pandehurit që nuk është zhvilluar asnjë aktivitet i paligjshëm gjithashtu sa i përket caktimit të lëndëve lidhur me shtetasit serbë.

Gjithashtu është e qartë prej nenit 14 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/59 që çfarëdo lloji i përdorimit të tokës që është konfiskuar nga pronarët e tij pasi që rregullorja ka hyrë në fuqi, është e pavlefshme.

Sa i përket vendimit mbi dënimin mbrojtja pretendon që asnjë dënim nuk mund të shqiptohet pasi që e pandehura është e pafajshme. Për më tepër, dënimi plotësues Ndalimi i Ushtrimit të Profesionit, i Aktiviteteve ose i Detyrës, është shumë i përgjithësuar dhe jo i specifikuar.

D. Ankesa e të pandehurës O.J.

Më 30 dhjetor 2014 e pandehura O.J. ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë mbi bazë të:

Shkeljes së konsiderueshme të dispozitave të procedurës penale;
Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
Vendimit mbi sanksionin penal.

E pandehura O.J. propozon që Gjykata e Apelit të miratojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që e pandehura të shfajësohet nga të gjitha akuzat ose të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën në gjykatën Themelore për rigjykim.

E pandehura pretendon se me vazhdimin dhe përfundimin e gjykimit pa praninë e të pandehurit F.B. dhe duke e shpallur vetë aktgjykimin dhe marrjen e deklaratave nga i pandehuri N.U., Kryetari i Trupit gjykues ka shkelur dispozitat e procedurës penale.

Për më tepër e pandehura pretendon që mungojnë prova të drejtpërdrejta të cilido element të veprës penale Nxjerrja e Kundërligjshme e Vendimeve Gjyqësore. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është i pajustificuar dhe i paligjshëm pasi që është jo logjik dhe kontradiktor dhe i bazuar në supozime e jo në prova. Gjykata Themelore në aktgjykimin e kundërshtuar bile thekson që nuk ka prova të drejtpërdrejta. Për më tepër Gjykata Themelore me qëllim shpërfilli të gjitha provat shfajësuese.

E pandehura gjithashtu pretendon që ajo e ka zbatuar në mënyrë të saktë Rregulloren e UNMIK-ut nr.2002/13 dhe që ajo e ka aplikuar ligjin në të njëjtën mënyrë në të gjitha lëndët e saj.

E. Ankesa e të pandehurve E.A. dhe F.B.

Më 5 janar 2015 të pandehurit E.A. dhe F.B. kanë parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë mbi bazë të:

Shkeljes esenciale të procedurës penale;
Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
Shkeljes së Kodit Penal të Kosovës.

Të pandehurit i propozojnë Gjykatës së Apelit të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që të pandehurit të shfajësohen nga të gjitha akuzat ose aktgjykimi i kundërshtuar të anulohet dhe t'i kthehet Gjykatës Themelore për rigjykim.

Të pandehurit pretendojnë se me vazhdimin dhe përfundimin e gjykimit pa praninë e të pandehurit F.B., kryetari i trupit gjykues ka shkelur dispozitat e procedurës penale.

Për më tepër të pandehurit pretendojnë se dispozitivi tejkalon aktakuzën pasi që faktet e caktuara të dëshmuara në dispozitiv nuk ishin të përfshira në aktakuzë.

Aktgjykimit të kundërshtuar i mungon arsyetim i qartë dhe i plotë lidhur me faktet vendimtare për vërtetimin e veprës penale dhe të përgjegjësisë penale për veprën penale. Ky arsyetim për më tepër është kontradiktor me provat tjera të paraqitura në shkresat e lëndës.

Nuk ka provë të drejtpërdrejtë se është bërë përfitim material, madje në aktgjykim theksohet që nuk ka provë të drejtpërdrejtë që të pandehurit me qëllim kanë nxjerrë vendime të paligjshme. Për më tepër faktet rrethore bazohen në supozimet dhe provat e interpretuara gabimisht. Përveç kësaj, Gjykata Themelore e ka bazuar arsyetimin e saj në supozimet e pavërtetuara lidhur me vendimin e kundërshtuar gjyqësor.

Sa i përket vërtetimit të gjendjes faktike për të pandehurit, ata pretendojnë që asnjë provë e drejtpërdrejtë apo rrethore nuk e konfirmon ekzistimin veprës penale të kryer nga të pandehurit. Nuk ka asnjë provë që i konfirmon elementet thelbësore e as që ka ndonjë provë që me vendimet e nxjerra gjyqësore do të mund të arrihej ndonjë përfitim material ose që do të mund të kryheshin favore. Gjithashtu nuk janë dëshmuar efekte të dëmshme të vendimeve gjyqësore.

Përveç kësaj vendimet e nxjerra gjyqësore u bënë të plotfuqishme dhe ankesat e AKM-së u hodhën poshtë.

Sa i përket shkeljeve të kodit penal, të pandehurit pretendojnë se nuk është dëshmuar qëllimi i të pandehurve që të përfitojnë materialisht prandaj edhe aktgjykimi fajësues nuk ka mundur të nxjerrët . As nuk është dëshmuar që dikujt i është shkaktuar dëm ose që dikujt i është bërë favor.

Për më tepër, të pandehurit si gjyqtarë kanë të drejtë në imunitet nga përndjekja penale bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës për vendimet e nxjerra gjyqësore.

Të pandehurit gjithashtu pretendojnë që rregulloret të cilat do të duhej të zbatoheshin ishin të pakuptueshme. Duke marrë parasysh situatën konfuze ligjore, me zbatimin e tri llojeve të legjislacionit dhe mungesën e trajnimit adekuat, është plotësisht e kuptueshme që edhe gjyqtarët më të mirë mund të kenë bërë gabime pa dashje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e normave të shumta.

Për më tepër, të pandehurit nuk i kanë zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet dhe Detyrimet. Me ankesë ata e kanë dorëzuar aktvendimin e DhPGJS SCA-08-0035 të datës 28.06.2013.

F. Ankesa e avokatit mbrojtës Visar Vehapi për të pandehurën S.M.

Më 29 dhjetor 2014 avokati mbrojtës Visar Vehapi në emër të pandehurës S.M. ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë mbi bazë të:

Shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 i KPP-së);
Shkelje të ligjit penal (neni 346 i KPP-së);
Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 386 i KPP-së).

Mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit që të miratojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që e pandehura S.M. të shfajësohet për të gjitha akuzat ose të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe t'ia kthejë lëndën Gjykatës Themelore për rigjykim.

Mbrojtja pretendon që dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë, kontradiktor në arsyetim dhe në gjendjen faktike dhe nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare. Gjithashtu, pjesa e arsyetimit të aktgjykimit është kontradiktore dhe provat janë vlerësuar në mënyrë të gabuar.

Për më tepër, aktgjykimi i kundërshtuar është i paqartë pasi që i pandehuri N.U. është dënuar për bashkëkryerje përderisa e pandehura S.M. nuk është dënuar për bashkëkryerje.

Në kundërshtim me dispozitivin, e pandehura ka pasur të bëjë vetëm me një lëndë e lidhur me NPP KBI Kosovo Export, dhe jo dy lëndë siç është vërtetuar gabimisht nga Gjykata Themelore.

Për më tepër Gjykata Themelore e ka keqinterpretuar Ligjin mbi detyrimet dhe e pandehura nuk ka vepruar në kundërshtim të Ligjit mbi Detyrimet.

Nuk ekziston provë e drejtpërdrejtë që është bërë përfitim material dhe këtë e thekson edhe aktgjykimi. Për më tepër, provat rrethore bazohen në supozime të pavërteta dhe kjo është plotësisht e pamjaftueshme.

Me vazhdimin dhe përfundimin e shqyrtimit pa praninë e të pandehurit F.B., kryetari i trupit gjykues ka shkelur dispozitat e procedurës penale.

Për më tepër, dënimi plotësues Ndalimi i ushtrimit të profesionit, i aktiviteteve ose detyrës është shumë i përgjithësuar dhe jo i specifikuar.

Sa i përket shkeljes së ligjit penal mbrojtja pretendon që Gjykata Themelore me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetojë që në veprimet e të pandehurve ka elemente të veprës penale. Nuk janë plotësuar kriteret objektive dhe subjektive për vërtetimin e veprës penale prandaj edhe e pandehura është dënuar gabimisht.

Për më tepër, të pandehurit, si gjyqtarë kanë të drejtë në imunitet nga përndjekja penale në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për vendimet e nxjerra gjyqësore.

Sa i përket gjendjes faktike, mbrojtja pretendon që duke marr parasysh situatën e ngatërruar ligjore, me zbatimin e tri llojeve të legjislacionit, interpretimin dhe zbatimin e shumë rregulloreve e pandehura i ka kryer në mënyrën më të mirë të mundshme. Gjykata Themelore është ajo që ka interpretuar Rregulloret e UNMIK-ut dhe i ka nxjerrë gabimisht vendimet gjyqësore në aktgjykimet e saja të kundërshtuara.

Nuk ka prova që është arritur apo do të mund të arrihej ndonjë përfitim material me vendimet e nxjerra gjyqësore. Gjithashtu nuk është dëshmuar asnjë efekt i dëmshëm i vendimeve gjyqësore. Gjithashtu nuk ekzistojnë prova që e pandehura ka vepruar me qëllim të nxjerrjes së vendimit të paligjshëm gjyqësor.

Për më tepër, vendimet e nxjerra gjyqësore të të pandehurës ende do të rishikohen nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës dhe është vetëm në kompetencën ekskluzive të kësaj gjykate që vendimet e nxjerra gjyqësore të të pandehurës mund të rishikohen.

G. Ankesa e të pandehurës S.S.

Më 24 dhjetor 2014 e pandehura S.S. ka parashtruar ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë në bazë të:

Shkeljes substanciale të dispozitave të procedurës penale;
Vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike;
Shkeljes së ligjit penal;
Vendimit të gabuar mbi sanksionin penal.

E pandehura S.S. i propozon Gjykatës së Apelit të miratojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që e pandehura të shfajësohet për të gjitha akuzat ose të anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe të kthejë lëndën në Gjykatën Themelore për rigjykim.

E pandehura pretendon që si gjyqtare, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ajo ka të drejtë në imunitet nga ndjekja penale për vendimet e nxjerra gjyqësore.

E pandehura përveç kësaj pretendon që dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë dhe i pakuptueshëm. Nuk ka përshkrim të hollësishëm se si është kryer vepra penale. Në vendimin e nxjerrë nuk përmendet se kujt i është dhënë toka dhe kush është dëmtuar. Për më tepër, nuk është dëshmuar që e pandehura ka pasur çfarëdo përfitimi material e as që është specifikuar që dikush ka përfituar nga vendimet gjyqësore të nxjerra nga e pandehura.

Sa i përket shkeljes së procedurës penale, e pandehura pretendon që ajo nuk e ka nënshkruar aktvendimin që ka ndryshuar aktvendimin e saj paraprak. Ka qenë i pandehuri N.U. që e ka nxjerr atë aktvendim. Prandaj e pandehura nuk mund të jetë përgjegjëse për atë aktvendim.

Edhe nëse e pandehura ka gabuar në vendimet e nxjerra gjyqësore, i mbetet instancave më të larta të japin udhëzime dhe të korrigjojnë çfarëdo gabimi eventual. Vendimi pa dyshim nuk është çështje e procedurave penale.

E pandehura më tutje pretendon se aktgjykimi i kundërshtuar nuk përmban një arsyetim specifik lidhur me veprimet e të pandehurës, por vetëm lidhur me aktet e të pandehurit N.U..

Sa i përket gjendjes faktike, e pandehura pretendon se nuk përmendet fare se kujt i është dhënë toka në fjalë. Për më tepër, i pandehuri nuk ka nënshkruar kurrfarë aktvendimi me të cilin ishte ndryshuar aktvendimi i saj fillestar. Ka qenë i pandehuri N.U. ai që e ka marrë aktvendimin në fjalë. Për këtë arsye, e pandehura nuk mund të mbahet përgjegjëse për veprimin e ndërmarrë nga

N.U.. Po ashtu, aktgjykimi i kundërshtuar është i paqartë, pasi që i pandehuri N.U. është dënuar për bashkëkryerje, përderisa, e pandehura S.S., në të vërtetë, nuk është dënuar për bashkëkryerje.

Më tej, Gjykata Themelore gabimisht ka konstatuar se është dashur të zbatohet Ligji mbi Kontratat dhe Detyrimet (LKD), pasi që ligji në fjalë nuk ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor, por në fuqi atëherë ka qenë ligji i vjetër mbi detyrimet.

Vendimi i marrë ka qenë vetëm i natyrës deklarative dhe askujt nuk i është shkaktuar kurrfarë dëmi. Vendimi i marrë pastaj është konfirmuar nga shkalla e dytë.

Sa i takon shkeljes së kodit penal, e pandehura pretendon se nuk ka prova të drejtpërdrejta se është përfituar dobi pasurore apo se është shkaktuar ndonjë dëm. Po ashtu nuk ka as prova të drejtpërdrejta se e pandehura ka lëshuar qëllimisht vendim të kundërligjshëm.

Lidhur me dënimin, e pandehura pretendon pikësëpari se nuk mund t'i shqiptohet kurrfarë dënimi pasi që nuk ka prova se e pandehura ka kryer vepër penale. Përveç kësaj, dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës nuk është proporcional me dënimin ndaj të bashkëpandehurve të tjerë, pasi që ata kanë marrë më shumë vendime. Në fund, dënimi plotësues i shqiptuar është tepër i ashpër.

Ajo e dorëzon edhe një fragment të Ligjit mbi marrëdhëniet dhe detyrimet nr. 04/L-077.

Plotësimi i ankesës

E pandehura më datën 26 janar 2016 ka parashtruar plotësim të ankesës së saj me prova të reja.

E pandehura e ka parashtruar aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Prizrenit C.nr. 101/107, të datës 4 qershor 2008, i cili ka marrë formën e prerë më 2 mars 2009. Kjo do të thotë se edhe Gjykata Komunale e Prizrenit ka marrë aktgjykim pa iu referuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përderisa ky aktgjykim ishte bile edhe detyruës. Aktgjykimi i marrë nga e pandehura, megjithatë, nuk ka qenë detyruës, por thjesht deklarativ. Ajo e parashtron edhe aktgjykimin në lëndën C.nr. 2333/2005.

H. Ankesa e mbrojtësit Shefki Syla për të pandehurin R.R.

Mbrojtësi Shefki Syla ka parashtruar ankesë për të pandehurin R.R. më datën 5 janar 2015 në Gjykatën Themelore të Prishtinës për shkak të:

Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 i KPP-së);
Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 386 i KPP-së);
Shkeljes së ligjit penal (neni 346 i KPP-së).

Mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit që ta miratojë ankesën si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që i pandehuri R.R. të lirohet nga të gjitha akuzat apo të anulohet aktgjykimin i kundërshtuar dhe të kthehet lënda për rigjykim në Gjykatën Themelore.

Mbrojtja parashtron se dispozitivi i aktgjykimin është i paqartë, kundërthënës me arsyetimin dhe me gjendjen faktike dhe nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare.

Gjithashtu, pjesa e arsytimit të aktgjykimit është kundërthënëse dhe provat janë vlerësuar gabimisht. Gjykata Themelore ka bërë konkluzione të pasakta, duke u bazuar në supozime. Me asnjë provë të vetme nuk është shpjeguar as mbështetur shkalla e dëmit të shkaktuar apo shkalla e dobisë pasurore të përfituar.

Duke qenë gjyqtar, i pandehuri ka të drejtë imuniteti nga ndjekja penale, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kur kemi të bëjmë me vendimet gjyqësore të marra.

Lidhur me gjendjen faktike, Gjykata Themelore gabimisht e ka interpretuar ligjin në raport me vendimet e marra. I pandehuri në fjalë ka zbatuar drejt ligjin që ka qenë në fuqi asokohe dhe vendimet e marra gjyqësore kanë qenë të ligjshme.

Ligji penal është shkelur për shkak të aktgjykimit dënues ndaj të pandehurit, përkundër faktit se i pandehuri nuk ka kryer kurrfarë vepre penale.

Për më tepër, varet nga instanca më e lartë nëse ajo do të rishikojë apo korrigjojë ndonjë gabim eventual në vendimet e marra nga i pandehuri. Vendimet në fjalë natyrisht nuk janë objekt trajtimi të procedurës penale.

I. Ankesa e të pandehurit T.M.

I pandehuri T.M. ka ushtruar ankesë më 5 janar 2015 në Gjykatën Themelore të Prishtinës për shkak të:

Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
Shkeljes së kodit penal;
Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
Vendimit mbi sanksionin penal.

I pandehuri T.M. i propozon Gjykatës së Apelit që ta pranojë ankesën si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar ashtu që i pandehuri në fjalë të lirohet nga të gjitha akuzat apo ta anulojë aktgjykimin e kundërshtuar dhe ta kthejë lëndën për rigjykim në Gjykatën Themelore.

I pandehuri parashtron se duke e vazhduar dhe duke e përmbyllur gjykimin pa praninë e të pandehurit F.B. dhe duke e shpallur aktgjykimin i vetëm, pa praninë e anëtarëve të tjerë të trupit gjykues si dhe duke i marrë deklaratat nga i pandehuri N.U., kryetari i trupit gjykues i ka shkelur dispozitat e procedurës penale.

Shkelja e kodit penal ka ndodhur kur Gjykata Themelore e ka dënuar të pandehurin, përkundër faktit se nuk ka elemente të veprës penale në aktivitetet e të pandehurit.

Sa i përket gjendjes faktike, i pandehuri parashtron se Gjykata Themelore e ka interpretuar legjislacionin përkatës në mënyrë të gabuar. Edhe pse i pandehuri nuk ishte thirrur në Ligjin mbi shitjen e pronës së paluajtshme, ai ka vepruar në mirëbesim dhe nuk ka bërë asgjë të kundërligjshme apo me ndonjë qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për

veten apo për të tjerët apo për t'i sjellë ndonjë dëm dikujt tjetër. Po ashtu, e vetmja gjykatë kompetente për rishikimin e vendimeve të të pandehurit është Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe jo gjykatat penale.

Për më tepër, i pandehuri nuk ka vepruar ndryshe prej gjyqtarëve të tjerë dhe aktgjykimet e përmendura të Gjykatës Themelore janë marrë katër vjet a më shumë pas vendimeve të të pandehurit të cilat janë objekt i aktakuzës.

Nuk ka prova të drejtpërdrejta se i pandehuri ka vepruar me paramendim dhe se aktgjykimi madje edhe e përmend se nuk ka prova të drejtpërdrejta se i pandehuri qëllimisht ka marrë vendim të kundërligjshëm. Provat rrethore më tutje janë të bazuara në supozime dhe në prova të interpretuara në mënyrë të gabueshme.

Gjykata Themelore, gjithashtu, e ka injoruar faktin se i pandehuri e ka shpallur veten jo kompetent pas vendosjes së Kosova Eksportit nën kontrollin direkt të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Në fund, dënimi i të pandehurit bazohet në opinionin publik dhe jo në arsye gjyqësore.

J. Ankesa e mbrojtësit Musa Dragusha për të pandehurën H.B.

Mbrojtësi Musa Dragusha në emër të të pandehurës H.B. ka parashtruar ankesë më datën 26 dhjetor 2014 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, për shkak të:

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
- Shkeljes së ligjit penal;
- Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike;
- Vendimit mbi sanksionin penal.

Mbrojtja i propozon Gjykatës së Apelit ta miratojë ankesën si të bazuar dhe ta ndryshojë aktgjykimin e kundërshtuar duke e liruar të pandehurën H.B. nga të gjitha akuzat.

Gjykata Themelore në mënyrë të gabueshme e ka vërtetuar se kontrata e punës e të pandehurës si avokate e WCJW-së për NSh KBI "Kosova Eksport" ishte ndërprerë nga NSh KBI apo nga AKM-ja, pasi që kontrata në fjalë në të vërtetë nuk ishte ndërprerë asnjëherë. Gjykata Themelore, po ashtu, në mënyrë të gabueshme ka vërtetuar se NSh KBI ishte shpërndarë dhe kishte pushuar së ekzistuari në vitin 1997. Gjykata Themelore, më tej, nuk e kishte vërtetuar se e pandehura kishte ofruar ndihmë në emër të KBI-së lidhur me lëndët, aktgjykimet të të cilave janë objekt i aktakuzës në fjalë. Megjithatë, e pandehura nuk ka pranuar kurrfarë trajnimi nga KBI lidhur me rregulloret përkatëse dhe kompetencat e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, dhe si rrjedhojë e kësaj, ajo nuk i kishte njohuritë e nevojshme lidhur me rregulloret në fjalë.

E pandehura nuk e ka pasur për qëllim kryerjen e veprës penale, pasi që nuk ka qenë në dijeni se veprimi apo mosveprimi i saj mund të sjellë dëm dhe pa dyshim se nuk ka pasur dëshirë të shkaktojë pasoja të kundërligjshme.

Mbrojtja pretendon se e pandehura ka qenë e obliguar që t'ia referojë ankesat e Gjykatës së Qarkut si gjykatë e shkallës së parë Gjykatës Komunale, porse edhe ajo e ka kundërshtuar çështjen e kompetencës së Gjykatës Komunale për të vendosur në lëndët në fjalë.

Gjykata Themelore nuk e ka provuar në mënyrë të mjaftueshme dashjen e të pandehurës për t'iu ndihmuar gjyqtarëve në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme dhe mosnjohimin e AKM-së lidhur me procedurat të cilat ishin duke vazhduar kundër KBI-së.

Sa i takon dënimit, mbrojtja deklaron se Gjykata Themelore nuk e ka marrë parasysh se e pandehura nuk ka të kaluar kriminale, rrjedh nga një familje e mirë, duhet të përkujdeset për të shoqin e sëmure dhe për fëmijët e papunësuar si dhe ka qenë duke vepruar nën urdhrat e drejtorit të KBI-së.

K. Ankesa e mbrojtësit Qerim Metaj për të pandehurin G.G.

Mbrojtësi Qerim Metaj, për të pandehurin G.G., ka bërë ankesë më 5 janar 2015 në Gjykatën Themelore të Prishtinës, për shkak të:

Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale (neni 384 i KPP-së);
Vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike (neni 386 i KPP-së);
Shkeljes së ligjit penal (neni 385 i KPP-së);
Vendimit mbi sanksionin penal dhe dënimin alternativ.

Mbrojtësi i propozon Gjykatës së Apelit miratimin e ankesës si të bazuar dhe ndryshimin e aktgjykimit të kundërshtuar duke e liruar G.G.n prej të gjitha akuzave apo anulimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe kthimin e lëndës për rigjykim në Gjykatën Themelore.

Mbrojtja parashtron se vepra penale për të cilën i pandehuri në fjalë është shpallur fajtor, nuk është përfshirë në aktakuzë, prandaj në këtë mënyrë Gjykata Themelore i ka shkelur dispozitat e procedurës penale kur e ka dënuar të pandehurin.

Mbrojtja më tutje pretendon se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i paqartë dhe kundërthënës me përmbajtjen e aktgjykimit dhe të arsyetimit.

Nuk ka prova të mjaftueshme për të provuar se i pandehuri qëllimisht iu ka ndihmuar gjyqtarëve me ndonjë vepër eventuale penale dhe se Gjykata Themelore po ashtu nuk e ka prezantuar asnjë fakt për ta mbështetur këtë gjë. I pandehuri është liruar nga akuza fillestare vetëm për t'u dënuar gabimisht për një akuzë të cilën ai po ashtu nuk e kishte bërë.

Është e rëndësishme të vërehet se i pandehuri ka qenë i vetmi avokat i akuzuar me aktakuzë, përderisa edhe disa avokatë të tjerë gjithashtu i kanë përfaqësuar klientët e tyre në lëndët e aktakuzës.

Vepra për të cilën akuzohet i pandehuri nuk është vepër penale, prandaj aktgjykimi dënues ndaj tij është i kundërligjshëm dhe për këtë arsye nuk mund t'i shqiptohet dënimi.

Plotësimi i ankesës

Mbrojtja më datën 31 dhjetor 2015 ka parashtruar plotësimin e ankesës me prova të reja.

Mbrojtja ka parashtruar aktvendimet në vijim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës: AC - I - 13-0120, të datës 6 korrik 2015, AC - I - 13-0124 - A001 dhe A0002 të datës 15 korrik 2015 si dhe AC - I - 13-0126 - A001 të datës 15 korrik 2015. Kjo do të thotë se çështja në pyetje ka të bëjë me procedurë kontestimore në vazhdim e sipër dhe nuk ka të bëjë me aktgjykim të formës së prerë, me të cilin ka mundur të shkaktohet dëmi.

Kjo nënkupton po ashtu se edhe Gjykata Komunale e Prizrenit ka marrë aktgjykimin pa iu referuar Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, përderisa ky aktgjykim ishte bile edhe detyrues. Aktgjykimi i marrë nga i pandehuri megjithatë, nuk ka qenë detyrues por thjesht deklarativ.

L. Përgjigjet ndaj ankesave

Mbrojtësi Visar Vehapi për të pandehurën S.M.

Në përgjigje të ankesës së parashtruar nga PSRK-ja, mbrojtja deklaron se nuk ka dyshim të bazuar se ekziston vepra penale në fjalë. Mbrojtja qëndron pranë ankesës së tyre.

E pandehura S.S.

Në përgjigje të ankesës së parashtruar nga PSRK-ja, e pandehura në fjalë deklaron se nuk është e qartë çfarë nënkupton PSRK-ja me shprehjen “prapësim i aktgjykimit të kundërshtuar”, dhe se kodi penal nuk parasheh dënim me “burgim të menjëhershëm”.

I pandehuri G.G.

Në përgjigje të ankesës së parashtruar nga PSRK-ja, i pandehuri deklaron se Gjykata e Qarkut me të drejtë e kishte liruar nga akuza dhënie e ndihmës në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm, por kishte gabuar kur e kishte dënuar për falsifikimin e dokumenteve zyrtare, pasi që i pandehuri nuk ishte akuzuar për këtë veprë. Për më tepër, ka skaduar afati i parashkrimit për veprën në fjalë. Po ashtu, nuk ka prova të mjaftueshme për ndonjë skemë të bashkëkryerjes.

M. Propozimi i prokurorisë së apelit

Prokurori i apelit më 7 korrik 2015 ka parashtruar propozimin që Gjykata e Apelit ta pranojë ankesën e PSRK-së dhe t'i refuzojë ankesat e avokatëve mbrojtës.

Prokurori i apelit i shtjellon në detaje ankesat dhe përgjigjet e PSRK-së dhe të mbrojtësve e të pandehurve. Thënë shkurt, prokurori i apelit i konsideron jomeritore shumicën e çështjeve të parashtruara në ankesat e mbrojtësve dhe të pandehurve. Megjithatë, sa i përket dënimit plotësues, prokurori i apelit i propozon Gjykatës së Apelit që ta vlerësojë nëse dënimet plotësuese janë shqiptuar drejt mjaftueshëm apo jo.

IV. GJETJET E KOLEGJIT

A. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

a. *Mungesa e të pandehurit F.B.*

Mbrojtja parashtron se shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale ka ndodhur kur kryetari i trupit gjykues të shkallës së parë ka vazhduar me seancën më 3 shtator 2014, edhe pse të pandehurit F.B. i është dashur ta braktisë seancën në fjalë për shkak të problemeve shëndetësore, pas të cilave nuk ka mundur më të kthehet.

Kjo arsye e dhënë në ankesë refuzohet si e pabazë.

Nga procesverbali i seancës më 3 shtator 2014, nuk mund të merret vesh se i pandehuri F.B. kishte dalë nga salla e gjykimit gjatë seancës. Për këtë arsye, pretendimi i mbrojtjes nuk mbështetet me prova.

b. *Dispozitivi*

Mbrojtja parashtron se dispozitivi është i paqartë dhe në kundërtënie me veten si dhe me provat e dhëna në shkresat e lëndës.

Edhe kjo arsye ankimore refuzohet si e pabazuar.

Dispozitivi është i qartë, logjik dhe nuk bie në kundërshtim me veten apo me arsyetimin. Dispozitivi ofron përshkrim koherent dhe të qartë të fakteve vendimtare dhe i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme, të përcaktuara me nenin 370, par. 3 dhe 4 të KPP-së, lidhur me nenin 365 të KPP-së. Dispozitivi është plotësisht koherent me arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar dhe i pasqyron të dhënat e shtjelluara aty. Gjykata Themelore i ka prezantuar arsyet për secilën pikë të vendimit në fjalë, siç përcaktohet me nenin 370, par. 6 të KPP-së. Dispozitivi nëse lexohet së bashku me arsyetimin e detajuar të aktgjykimit të kundërshtuar ofron një vlerësim të qartë të provave dhe të fakteve të cilat Gjykata Themelore i ka konsideruar të provuara apo të paprovuara. Në përputhje me nenin 370, par. 7 të KPP-së, Gjykata Themelore po ashtu ka bërë vlerësim të detajuar të besueshmërisë së provave kundërtëne dhe të arsyeve të cilat e kanë udhëhequr Gjykatën Themelore në vendosjen e çështjeve faktike dhe ligjore.

c. *Shqyrtimi i provave*

Mbrojtja pretendon se Gjykata Themelore nuk ka arritur të bëjë vlerësimin e provave në mënyrë të ndarë dhe të përbashkët.

Kolegji nuk gjen asnjë shkelje të këtyre dispozitave në lëndën në fjalë.

Është e qartë nga analiza e hollësishme në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar se Gjykata Themelore ka bërë një analizë të kujdesshme dhe të hollësishme të provave në këtë lëndë. Edhe pse mbrojtja mund të mos pajtohet me konkluzionet e Gjykatës Themelore tek të cilat ajo ka arritur pas kryerjes së analizave të provave; ky mospajtim është sfidë në vete. Mbrojtja

megjithatë nuk mund të pretendojë në mënyrë të logjikshme se Gjykata Themelore nuk i ka përmbushur detyrën e shqyrtimit të kujdesshëm të provave me përkushtim maksimal profesional.

Trupi gjykues e ka zhvilluar gjykimin në mënyrë të paanshme dhe i ka shqyrtuar në mënyrë të kujdesshme propozimet e mbrojtjes dhe të prokurorisë për prova, pa bërë dallime në mes të tyre duke i vlerësuar dhe peshuar në mënyrë të kujdesshme provat dhe argumenteve të të dyja palëve. Kjo është e qartë nga aktgjykimi i kundërshtuar dhe nga arsyetimi i dhënë nga trupi gjykues. Përsëri, kolegji e përsërit edhe një herë se çështja nëse konkluzionet e Gjykatës Themelore lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike kanë qenë të drejta dhe të plota është një çështje tjetër e cila do të vlerësohet në seancën e radhës së këtij aktgjykimi.

B. Provat e reja gjatë procedurës së apelit

Gjatë procedurës së apelit, mbrojtja ka parashtruar disa aktgjykime të marra nga DhPGjS-ja të cilat duhet të përfshihen në shkresat e lëndës si prova të reja. Prokuroria e ka kundërshtuar përfshirjen e këtyre aktgjykimeve si prova të reja, pasi që një gjë e tillë duhet të bëhet gjatë mbajtjes zyrtare të shqyrtimit para Gjykatës së Apelit.

Kolegji konstaton se duke e parë se të gjitha aktgjykimet e dorëzuara nga ana e mbrojtjes janë aktgjykime në të cilat ka qasje edhe publiku, pra i takojnë domenit publik, nuk është e nevojshme të mbahet shqyrtimi për t'i pranuar këto aktgjykime si prova të reja, në përputhje me nenin 392 të KPP-së. Aktgjykimet e dorëzuara prandaj do të përfshihen në shkresat e lëndës në cilësinë e provave të reja, ndërsa hedhet poshtë kundërshtimi i prokurorisë.

Të gjitha dokumentet e tjera të prezantuara në ankesa, në plotësimet e ankesave dhe gjatë seancën nuk pranohen si prova të reja. Të gjitha këto prova kanë ekzistuar edhe në kohën e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor prandaj kanë mundur të prezantohen atëherë. Gjykata ka vendosur se nuk ka nevojë të mbahet seancë dëgjimore, për shkak se edhe nëse pranohen këto prova, prapë nuk mund t'i ndryshojnë gjetjet faktike si dhe epilogun përfundimtar.

C. Vërtetimi i gjendjes faktike

Mbrojtja parashtron se Gjykata Themelore nuk i ka vlerësuar drejt provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe rrjedhimisht ka ardhur gjer tek konkluzionet e gabuara sa iu përket veprave penale dhe rolit të të pandehurve.

Prokuroria po ashtu pretendon se Gjykata Themelore ka ardhur në konkluzione të gabueshme sa i përket edhe vërtetimit të veprës penale të kryer nga i pandehuri G.G..

Para vlerësimit të çështjeve meritore të argumenteve të prezantuara nga mbrojtja lidhur me gjoja vërtetimin e gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji e përsërit edhe një herë standardin e rishikimit lidhur me gjetjet faktike të bëra nga trupi gjykues.

Është e qartë nga neni 386 i KPP-së se nuk mjafton që ankuesi vetëm të demonstrojë një lajthim faktik apo vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike nga ana e trupit gjykues. Në vend të kësaj, pasi që kodi i procedurës penale kërkon që vërtetimi i gabueshëm apo jo i plotë i gjendjes faktike

lidhet me ‘faktin material’, ankuesi duhet gjithashtu të konstatojë se vërtetimi i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike vërtet lidhet me faktin material, d.m.th. është i rëndësishëm kritike për vendimin e marrë.¹ Për më tepër, është parim i përgjithshëm i procedurës së apelit që Gjykata e Apelit duhet ta marrë parasysh gjetjen faktike të trupit gjykues për shkak se pikërisht trupi gjykues është në pozitën më të mirë për t’i vlerësuar provat. Gjykata Supreme e Kosovës shpesh ka shprehur qëndrimin e saj se duhet patjetër “*të respektohet vlerësimi i bërë nga trupi gjykues sa i përket besueshmërisë së dëshmitarëve të cilët janë paraqitur personalisht gjatë gjykimit dhe kanë dëshmuar para tyre. Nuk i shkon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta injorojë vlerësimin e bërë nga trupi gjykues rreth besueshmërisë së këtyre dëshmitarëve, në qoftë se nuk ka bazë të qëndrueshme për të bërë një gjë të tillë.*” Standardi të cilin e ka zbatuar Gjykata Supreme ka qenë “*që mos t’i ndryshojë gjetjet e gjykatës që ka gjykuar çështjen, vetëm nëse provat në fjalë në të cilat është mbështetur gjykata që e ka gjykuar çështjen nuk janë pranuar nga asnjë tribunal i arsyeshëm faktik apo kur vlerësimi i tyre ka qenë tërësisht i gabueshëm*”.²

Duke i pasur në mendje këto që u thanë më lart, kolegji e ka rishikuar vlerësimin e bërë nga Gjykata Themelore të provave të administruara dhe të gjendjes faktike.

a. Pranueshmëria e provave

Kolegji i ka vlerësuar provat e prezantuara gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor, siç është theksuar në paragrafët 19 deri në 24 të aktgjykimit të kundërshtuar të Gjykatës Themelore. Kolegji po ashtu i ka shqyrtuar edhe provat e propozuara të përbëra nga transkripti i audio regjistrimit të bisedës së zhvilluar në mes të pandehurit G.G. dhe K.U., siç iu referohet Gjykata Themelore paragrafëve 26 deri në 28 të aktgjykimit të kundërshtuar. Kolegji më tutje e ka rishikuar pranueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit F.T. dhe të memorandumit të brendshëm të UNMIK-ut Ref: DOJ/JDD/08/bf02335 të datës 9 qershor 2008.

Sipas pikëpamjes së kolegjit, Gjykata Themelore ka ardhur në konkluzione logjike gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së provave. Kolegji për më tepër konstaton se deklarata e dëshmitarit F.T. si dhe memorandumit i brendshëm të UNMIK-ut Ref: DOJ/JDD/08/bf02335, të datës 9 qershor 2008 janë prova të pranueshme dhe në këtë drejtim e miraton në tërësi analizën e Gjykatës Themelore. Sa i përket provave të reja të transkriptit të audio regjistrimit të bisedës së zhvilluar në mes të pandehurit G.G. dhe të K.U., kolegji po ashtu pajtohet plotësisht me arsyetimin e Gjykatës Themelore, siç përcaktohet në par. 28 të aktgjykimit të kundërshtuar dhe me aktvendimin e kryetarit të kolegjit të datës 28 janar 2014, duke i konsideruar prova të papranueshme.

Ankesat e mbrojtjes dhe ankesa e prokurorisë në këtë drejtim prandaj refuzohen si të pabazuara.

b. Faktet e vërtetuara

Kolegji e ka shqyrtuar analizën e detajuar të Gjykatës Themelore lidhur me vendimet e marra gjatë viteve 2006 dhe 2007, nga ana e të pandehurve O.J., S.M., S.S. dhe T.M., të gjithë gjyqtarë të Gjykatës Komunale të Prishtinës, si dhe të gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës R.R.,

¹ Shih po ashtu B. Petric,; komentimi i neneve të ligjit jugosllav të procedurës penale, botimi i dytë i vitit 1986, neni 366, par. I. 3.

² Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 84/2009, 3 dhjetor 2009, par. 35; Gjykata Supreme e Kosovës, AP-KZi 2/2012, 24 shtator 2012, par. 30.

E.A. dhe F.B., në 15 lëndët lidhur me tokën në pronësinë shoqërore. I pandehuri N.U. në atë kohë ka qenë kryetar i Gjykatës Komunale të Prishtinës. Të pandehurit H.B. dhe G.G. kanë qenë juristë të cilët kanë marrë pjesë në disa faza të procedurës në cilësinë e përfaqësuesve të palëve.

Sipas pikëpamjes së kolegjit, Gjykata Themelore vjen deri tek konkluzioni logjik gjatë vlerësimit të provave në fjalë, siç është shtjelluar në par. 36 deri në 216 të aktgjykimit të kundërshtuar. Kolegji konstaton se nuk ka bazë për dyshime se gjendja materiale nuk është vërtetuar drejt. Po ashtu, kolegji nuk konsideron se Gjykata Themelore e ka interpretuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë provë.

Kolegji tërësisht e miraton dhe e vërteton analizën e Gjykatës Themelore se:

15 vendime janë marrë nga gjyqtarët e Gjykatës Komunale të Prishtinës pa iu referuar fare DhPGjS-së, në kundërshtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13.

Në përjashtim të njëres prej tyre, në të gjitha këto lëndë kurrfarë njoftimi mbi kërkesat pronësore nuk i janë dërguar AKM-së para nxjerrjes së vendimit, në kundërshtim me Rregulloren nr. 2002/12.

Një lëndë është vendosur nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës, në të cilën gjyqtarët kishin vendosur rreth një ankese pa pasur juridiksion, në kundërshtim me Rregulloren nr. 2002/13.

Të gjitha kërkesat pronësore kanë qenë të bazuara në Ligjin mbi detyrimet, Gazeta zyrtare e RSFJ-së nr. 29/78, ligj i cili nuk ka qenë ligji i duhur për t'u zbatuar.

Gjatë procedurës, gjyqtarët nuk kanë arritur të sigurojnë prova dhe fakte për vërtetimin e pronësisë ligjore të pasurive të pretenduara nga ana e paditësve, dhe nuk kanë arritur ta konfirmojnë autencitetin e kontratave mbi shitjen, në të cilat janë bazuar kërkesat pronësore. Gjyqtarët nuk kanë arritur ta konfirmojnë autencitetin e certifikatave të vdekjes, të cilat janë dorëzuar në gjykatë si provë se të pandehurit kanë qenë pronarë historikë të tokës në fjalë.

Në vend të saj është ndarë një truall tjetër që nuk ka qenë mjet juridik i përcaktuar me Rregulloren nr. 2002/13 por as me asnjë ligj tjetër të zbatueshëm.

Toka në fjalë është ndarë si kompensim, gjë e cila nuk paraqet mjet juridik të përcaktuar as me Rregulloren nr. 2002/13 as me asnjë ligj tjetër të zbatueshëm.

Kolegji i apelit konstaton se nuk qëndron pretendimi i të pandehurës S.M. se ishte marrë vetëm me një lëndë lidhur me KBI “Kosova Eksport”. Nga shkresat e lëndës është e qartë se KBI “Kosova Eksport” ka qenë palë e paditur në të dyja rastet – C. Nr. 1698/05 dhe C. Nr. 251/04.

Si përfundim, kolegji konstaton se Gjykata Themelore e ka vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike në këto 15 lëndë. Nuk ka arsye, të cilat e zbehin korrektësinë apo besueshmërinë

e vërtetimit të fakteve materiale. Rrjedhimisht nuk është shkelur neni 386 i KPP-së, ndërsa kolegji i refuzon ankesat e mbrojtjes dhe të prokurorisë, lidhur me këto pretendime.

D. Nxjerrja e vendimit të kundërligjshëm gjyqësor nga ana e të pandehurve O.J., S.M., S.S. dhe T.M.

Neni 346 i KPK përcakton si më poshtë:

Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore

Gjykatësi, gjykatësi laik ose gjykatësi për kundërvajtje i cili me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete ose për personin tjetër ose për t'i shkaktuar dëm personit tjetër nxjerr vendim të kundërligjshëm dënohet me burgim prej gjashtë muajve deri në pesë vjet.

Është e qartë nga formulimi i nenit 346 të KPPK-së se nuk duhet vetëm vendimi të nxirret kundërligjshëm; por edhe gjyqtari duhet patjetër ta ketë pasur dashjen që të përfitojë dobi pasurore të kundërligjshme për veten apo për dikë tjetër ose që t'i shkaktojë dëm dikujt tjetër.

Neni 15 i KPPK-së përcakton si në vijim:

Dashja

- (1) Vepra penale mund të kryhet me dashje direkte ose eventuale.
- (2) Personi vepron me dashje direkte kur është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj.
- (3) Personi vepron me dashje eventuale kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose i mosveprimit të tij dhe ai pranon shkaktimin e saj.

Nuk kontestohet që të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M. kanë marrë vendimet e tyre në këto lëndë të tyre: 1314/07, 1698/05, 53/06, 429/05, 3/06, 1849/06, 1147/06, 3521/04, 1415/2005, 1738/07, 1908/3, 342/06, 1918/06, 251/04 dhe 2333/05. Mbrojtja, megjithatë, nuk e konteston se marrja e vendimeve përbën veprën penale të nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm gjyqësor.

a. Kundërligjshmëria

Kolegji e vërteton vlerësimin e Gjykatës Themelore se ligji procedural është shkelur përmes shkeljes së vendimeve përkatëse. Lëndët në fjalë janë gjykuar nga gjyqtarë të Gjykatës Komunale pa iu referuar fare DhPGjS-së, siç kërkohej me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13 si dhe në shumicën e lëndëve, AKM-ja (tash AKP-ja) nuk është njoftuar fare rreth kërkesave pronësore kundër NSh KBI-së, siç përcaktohej me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/12. Më pastaj është vërtetuar se ka pasur edhe shkelje të ligjit material. Kërkesat pronësore dhe vendimet në fjalë kanë qenë të mbështetura në ligjin mbi detyrimet, i cili nuk ka qenë i zbatueshëm për detyrimet kontraktuale të cilat janë lidhur para hyrjes në fuqi të Ligjit mbi detyrimet. Një tjetër shkelje e ligjit material ka ndodhur po ashtu kur janë dhënë troje si zëvendësim. Për më tepër, gjyqtarët nuk kanë arritur të sigurojnë prova dhe fakte me të cilat do të vërtetohej se paditësit ishin pronarët e ligjshëm të pasurive të pretenduara, si dhe nuk kanë arritur ta konfirmojnë vërtetësinë e certifikatave të vdekjes, të cilat janë parashtruar në gjykatë si provë se paditësit kanë qenë pronarë historikë të tokës përkatëse.

Kolegji konsideron se këto shkelje, individuale dhe posaçërisht të kombinuara, janë të tilla sa që në mënyrë substanciale kanë ndikuar në epilogun e lëndëve në fjalë dhe rrjedhimisht vendimet në fjalë janë qartë të gabuara dhe qartë të kundërligjshme.

Duke i pasur parasysh të gjitha këto që u cekën më lart, kolegji pajtohet plotësisht me vlerësimin e Gjykatës Themelore se vendimet e marra nga të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M. në lëndët e tyre përkatëse 1314/07, 1698/05, 53/06, 429/05, 3/06, 1849/06, 1147/06, 3521/04, 1415/2005, 1738/07, 1908/3, 342/06, 1918/06, 251/04 he 2333/05 kanë qenë vendime të kundërligjshme në kuptim të nenit 346 të KPK-së.

b. Dashja

Siç është përmendur nga Gjykata Themelore, është e rëndësishë jetike që të bëhet dallimi në mes të vendimit i cili merret nga gjyqtari që beson se ligji është zbatuar në mënyrë të drejtë, por që një vendim i tillë më vonë konstatohet të jetë i padrejtë nga gjykata e shkallës së dytë, dhe të vendimit i cili është marrë nga gjyqtari që qëllimisht e zbaton ligjin në mënyrë të padrejtë.

Vendimi i kundërligjshëm

Sa i përket dashjes së të pandehurës O.J. për të nxjerrë vendime të kundërligjshme, kolegji e miraton në tërësi arsyetimin e Gjykatës Themelore, siç është përcaktuar në par. 260 – 269 si dhe 271 – 279 të aktgjykimit të kundërshtuar. Në përfundim, kolegji konstaton se, duke e parë se e pandehura në fjalë është informuar me kohë lidhur me ligjet e zbatueshme dhe ka ndjekur seminare rreth temës në fjalë, pastaj duke e parë se kolegët e saj gjyqtarë dhe anëtarë të stafit të Gjykatës Komunale të Prishtinës e zbatonin drejt ligjin, pastaj duke e parë se edhe e pandehura e zbatonte drejt ligjin në lëndët e tjera dhe duke e parë vetë numrin e parregullsive dhe lëshimeve lidhur me caktimin e lëndëve në rastet në fjalë si dhe duke e pasur parasysh ligjin e zbatuar procedural dhe material, e pandehura O.J. qëllimisht kishte nxjerrë vendime të kundërligjshme gjyqësore.

Sa i takon dashjes së të pandehurës S.M. për të nxjerrë vendime të kundërligjshme, kolegji e miraton në tërësi arsyetimin e Gjykatës Themelore, siç është përcaktuar në par. 296 – 300 si dhe 303 – 306 të aktgjykimit të kundërshtuar. Në përfundim, kolegji konstaton se, duke e parë se e pandehura në fjalë është informuar me kohë lidhur me ligjet e zbatueshme, pastaj duke e parë se kolegët e saj gjyqtarë dhe anëtarë të stafit të Gjykatës Komunale të Prishtinës e zbatonin drejt ligjin, pastaj duke e parë se edhe e pandehura e zbatonte drejt ligjin në lëndët e tjera dhe duke e parë vetë numrin e parregullsive dhe lëshimeve lidhur me caktimin e lëndëve në rastet në fjalë si dhe duke e pasur parasysh ligjin e zbatuar procedural dhe material, e pandehura S.M. qëllimisht kishte nxjerrë vendime të kundërligjshme gjyqësore.

Sa i takon dashjes së të pandehurës S.S. për të nxjerrë vendim të kundërligjshëm, kolegji përsëri miraton në tërësi arsyetimin e Gjykatës Themelore, siç përcaktohet në par. 310 – 315 të aktgjykimit të kundërshtuar. Në përmbledhje, kolegji konstaton se, duke e parë se e pandehura në fjalë është informuar me kohë lidhur me ligjet e zbatueshme, pastaj duke e parë se kolegët e saj gjyqtarë dhe anëtarë të stafit të Gjykatës Komunale të Prishtinës e zbatonin drejt ligjin, pastaj duke e parë se edhe e pandehura e zbatonte drejt ligjin në lëndët e tjera si dhe vetë deklarata e të pandehurës se ajo e dinte se lënda duhet t'i referohej Dhomës së Posaçme, e pandehura S.M. qëllimisht e kishte nxjerrë një vendim të kundërligjshëm gjyqësor.

Sa i përket deklaratës së të pandehurës se ajo ishte kërcënuar apo detyruar me forcë që të marrë vendimin në fjalë, kolegji konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme për ta vërtetuar pohimin në fjalë.

Sa i takon dashjes së të pandehurit T.M. për të nxjerrë vendime të kundërligjshme, kolegji e miraton në tërësi arsyetimin e Gjykatës Themelore, siç përcaktohet në par. 319 – 322 si dhe 324 – 327 të aktgjykimit të kundërshtuar. Në përfundim, kolegji konstaton se, duke e parë se i pandehuri në fjalë është informuar me kohë lidhur me ligjet e zbatueshme, pastaj duke e parë se kolegjet e saj gjyqtarë dhe anëtarë të stafit të Gjykatës Komunale të Prishtinës e zbatonin drejt ligjin, dhe duke e parë vetë numrin e parregullsive dhe lëshimeve lidhur me caktimin e lëndëve në rastet në fjalë si dhe duke e pasur parasysh ligjin e zbatuar procedural dhe material, i pandehuri T.M. qëllimisht kishte marrë vendime të kundërligjshme gjyqësore.

Dobia pasurore apo dëmi i shkaktuar

Sa i takon dashjes së të pandehurve O.J., S.M., S.S. dhe T.M. për të nxjerrë vendime të kundërligjshme me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për veten ose për ndonjë person tjetër apo për t'i shkaktuar dëm personit tjetër, kolegji nuk pajtohet me vlerësimin e Gjykatës Themelore. Kolegji pajtohet me mbrojtjen se nuk ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit në fjalë kanë vepruar në këtë mënyrë me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore. Prokuroria nuk ka arritur të prezantojë asnjë provë e cila do ta demonstronte në mënyrë adekuate dashjen e të pandehurve për të përfituar dobi pasurore. Megjithatë, kolegji konstaton se ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se vendimet e kundërligjshme janë marrë me qëllim të shkaktimit të dëmit një personi tjetër. Duke i pasur parasysh të gjitha ato çfarë janë thënë më lart lidhur me vendimet qartë të gabuara dhe në mënyrë evidente të kundërligjshme si dhe rrethanat që e kanë përcjellë nxjerrjen e vendimeve në fjalë, të pandehurit kanë qenë në dijeni se me nxjerrjen e qëllimshme të këtyre vendimeve të kundërligjshme do t'i shkaktonte dëm *mes tjerash* AKP-së (AKM-së së dikurshme) dhe Kosovës, e me këtë pra qytetarëve të Kosovës.

Kolegji, prandaj, do ta ndryshojë dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar në atë mënyrë që do ta theksojë se vendimet e kundërligjshme gjyqësore të nxjerra nga të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M. janë marrë me qëllim të shkaktimit të dëmit një personi tjetër.

Kolegji sërish e thekson edhe një herë se në lëndën në fjalë duhet të bëhet dallimi në mes të vendimit, i cili merret nga gjyqtari që qëllimisht e zbaton ligjin gabimisht prej vendimit, i cili merret nga gjyqtari që beson se e ka zbatuar ligjin drejt, por që më vonë është konstatuar të jetë vendim i padrejtë nga gjykata e shkallës së dytë. Kolegji, rrjedhimisht, e refuzon edhe argumentin e mbrojtjes se me ndjekjen penale të të pandehurve gjoja është shkelur paanshmëria dhe pavarësia e gjyqtarit, e po ashtu gjoja është shkelur edhe Kushtetuta e Kosovës. Gjyqtari nuk mund të fshihet mbrapa parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë me qëllim që të kryejë vepra penale. Kushtetuta garanton imunitet për gjyqtarët, përveç për veprat penale të kryera prej tyre.

Ankesat e mbrojtjes në këtë drejtim refuzohen si të pabazuara.

E. Ndihma në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm gjyqësor nga e pandehura H.B.

Siç është konstatuar më lart, të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M. shpallen fajtorë për veprën penale të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore.

Neni 25 i KPK-së përcakton si në vijim:

Ndihma

(1) Kushdo që me dashje e ndihmon tjetrin të kryejë vepër penale dënohet sipas nenit 65

(2) të këtij Kodi.

(2) Ndihma për të kryer një vepër penale përfshin këshillimin ose udhëzimin se si kryhet vepra penale, duke vënë në dispozicion të kryerësit mjetet për kryerjen e veprës penale, duke larguar pengesat për kryerjen e veprës penale ose duke i premtuar paraprakisht se do t'i fshehë provat e veprës së kryer penale, identitetin e kryerësit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale.

E pandehura H.B. ka marrë pjesë në këtë lëndë në cilësinë e palës, duke e parë se ajo ishte prezantuar si përfaqësuese ligjore e NSh KBI-së gjatë procedurës gjyqësore. Kjo e pandehur nuk e kishte njoftuar AKM-në (tash AKP) lidhur me kërkesën pronësore të bërë kundër NSh-së dhe nuk e kishte kundërshtuar juridiksionin e Gjykatës Komunale, duke iu shmangur në këtë mënyrë edhe AKM-së (tash AKP-së) edhe DhPGjS-së. Kolegji pajtohet në tërësi me Gjykatën Themelore se me veprime dhe me lëshime të tilla, e pandehura H.B. në mënyrë të drejtpërdrejtë ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale të nxjerrjes së vendimeve të kundërligjshme gjyqësore. Ka qenë obligim i saj që ta mbrojtë pasurinë dhe interesat e NSh KBI-së, por ajo nuk e ka bërë një gjë të tillë.

Sa i përket dashjes së të pandehurës H.B. për të nxjerrë vendime të kundërligjshme, kolegji e mbështet arsyetimin e Gjykatës Themelore, siç përcaktohet në par. 337 – 341 të aktgjykimit të kundërshtuar. Kolegji, megjithatë, nuk e miraton arsyetimin në fjalë lidhur me dashjen e të pandehurës për të përfituar dobi pasurore, pasi që dashja e të pandehurës duhet vetëm të vërtetohet lidhur me ndihmën në kryerjen e veprës penale dhe jo në vetë kryerjen e veprës penale. Për këtë arsye, nuk ka rëndësi nëse e pandehura H.B. kishte si qëllim përfitimin e dobisë pasurore apo shkaktimin e dëmit, kur kemi të bëjmë me veprën penale të ndihmës në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm.

Në fund, kolegji konstaton se, duke e parë se e pandehura në fjalë nuk ka qenë e ngarkuar ta përfaqësojë NSh KBI-në por përkundër kësaj ka ndër marrë veprime aktive për t'u dukur sikur ta kishte pasur një detyrë të tillë, e pandehura në fjalë është dashur të ishte në dijeni rreth procedurave të duhura të zbatueshme dhe pasi që vetë e pandehura e kishte pranuar se me dije kishte shkelur ligjet e zbatueshme, atëherë e pandehura H.B. qëllimisht ka ndihmuar në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme gjyqësore.

Ankesa e mbrojtjes rrjedhimisht, refuzohet si e papazuar.

F. Ndihma në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm gjyqësor nga i pandehuri G.G.

Ashtu sikur Gjykata Themelore edhe kolegji konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme për ta provuar përtej dyshimit të arsyeshem se i pandehuri G.G. qëllimisht ka ndihmuar në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme. Edhe nëse provat për përgjimin e bisedave telefonike do të ishin

shpallur të pranueshme, prapë nuk do të kishte prova të mjaftueshme për të provuar se i pandehuri në fjalë ka vepruar me dashje për të ndihmuar në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme, e jo me dashjen e sigurimit të epilogut më të dobishëm për klientët e vet. Në kundërshtim me pohimin e prokurorisë, avokatët nuk kanë ndonjë detyrim ligjor automatik që ta njoftojnë gjykatën në qoftë se nuk zbatohet drejt ligji i zbatueshëm. Në këtë rast, i pandehuri në fjalë vetëm është dashur t'i përfaqësojë klientët e tij sa më mirë që ka pasur mundësi. Nuk varet nga avokati që ta zbatojë ligjin drejt, zbatimi i drejtë i ligjit varet nga gjykata. Gjyqtarët kanë mundur shumë lehtë t'i injorojnë parashtrirat e të pandehurit, prandaj veprimet e tija nuk kanë pasur ndonjë rol me rëndësi në nxjerrjen e vendimeve të kundërligjshme në fjalë. Kolegji e vërteton vlerësimin e bërë nga Gjykata Themelore, siç përcaktohet në par. 349 – 350 të aktgjykimit të kundërshtuar.

Kolegji, megjithatë, nuk e vërteton dënimin lidhur me veprën e ricilësuar të falsifikimit të dokumenteve. Siç është përmendur nga mbrojtja dhe prokuroria, afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale për veprën falsifikim i dokumenteve është katër vjet nga kryerja e veprës penale, sipas nenit 90, par. 6, dhe nenit 91, par. 6, lidhur me nenin 332, par. 1 të KPK-së. Duke e parë se vepra penale në fjalë ka ndodhur gjatë viteve 2006 dhe 2007, afati absolut i parashkrimit të veprës ka skaduar kaheër. Rrjedhimisht, ndalohet ndjekja penale për veprën penale në fjalë.

Si përfundim, kolegji e liron të pandehurin G.G. për pikën 2.

Ankesa e mbrojtjes pranohet, ndërsa ankesa e prokurorisë refuzohet si e pabazë.

G. Nxjerrja e vendimit të kundërligjshëm gjyqësor nga të pandehurit E.A., F.B. dhe R.R.

Nuk kontestohet se të pandehurit E.A., F.B. dhe R.R. e kanë nxjerrë vendimin në lëndën 604/2003. Mbrojtja, megjithatë, e konteston se nxjerrja e vendimit në fjalë përbën veprë penale të nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm gjyqësor.

a. Kundërligjshmëria

Kolegji e vërteton vlerësimin e Gjykatës Themelore se me nxjerrjen e vendimeve përkatëse është shkelur ligji procedural. Kjo lëndë është vendosur nga gjyqtarët e Gjykatës së Qarkut pa ia referuar fare DhPGJS-së dhe lënda në fjalë nuk i ishte referuar Gjykatës Komonale si gjykatë e shkallës së parë nga DhPGJS-ja. Rrjedhimisht, nuk kishte bazë ligjore që Gjykata e Qarkut ta pranonte juridiksionin dhe ta vendoste ankesën në fjalë. Për më tepër, ka pasur edhe shkelje të ligjit material pasi që ankesa mbështetej në një vendim, i cili ishte bazuar në Ligjin mbi detyrimet dhe toka në pyetje ishte ndarë në formë të kompensimit. Kolegji pajtohet plotësisht me vlerësimin e Gjykatës Themelore që vendimet e nxjerra nga të pandehurit E.A., F.B. dhe R.R. në lëndën nr. 604/2003 kanë qenë vendime të kundërligjshme, në kuptim të nenit 346 të KPK-së.

b. Dashja

Siç është theksuar nga Gjykata Themelore, është e rëndësisë jetike që të bëhet dallimi në mes të vendimit, i cili merret nga gjyqtari që beson se e ka zbatuar ligjin drejt, por që më vonë konstatohet se është vendim i padrejtë, si dhe vendimit, i cili merret nga gjyqtari që qëllimisht e zbaton ligjin në mënyrë të padrejtë.

Në këtë rast, kolegji konstaton se edhe pse janë disa dyshime, ekzistojnë prova të pamjaftueshme të cilat provojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit në fjalë qëllimisht kanë nxjerrë vendim të kundërligjshëm. Të pandehurit posa e kishin trajtuar një lëndë kur ankesa tashmë iu ishte drejtuar menjëherë. Nuk ka prova të mjaftueshme se ata kishin vepruar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme apo të shkakimit të dëmit personit tjetër.

Në përfundim, kolegji i shfajëson prej Pikës 1 të pandehurit E.A., F.B. dhe R.R..

Ankesa e mbrojtjes pranohet.

H. Nxitja e personit tjetër për të nxjerrë vendim të kundërligjshëm gjyqësor, nga i pandehuri N.U.

Gjykata Themelore e ka ricilësuar akuzën fillestare nxitje e personit tjetër për të nxjerrë vendim të kundërligjshëm gjyqësor në veprën penale nxjerrje e vendimit të kundërligjshëm gjyqësor, në bashkëkryerje dhe e ka dënuar të pandehurin N.U. për këtë vepër të ricilësuar.

Kolegji, gjithashtu, konstaton se nuk ka prova të mjaftueshme për të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri N.U. ka dhënë kontribut të ndjeshëm në nxjerrjen e vendimit të kundërligjshëm nga të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M.. Edhe pse ka parregullsi të dyshimta sa i përket ndarjes së lëndëve, prokuroria nuk ka arritur të prezantojë prova konkrete që parregullsitë në fjalë janë shkaktuar nga i pandehuri N.U., pastaj edhe nëse këto parregullsi janë shkaktuar nga i pandehuri N.U. me qëllim të mundësimit të nxjerrjes së vendimit të kundërligjshëm nga të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M., e në mënyrë më specifike për vendimet konkrete të nxjerra. Vetë obligimi i kryetarit të Gjykatës Komonale të Prishtinës për ndërmarrjen e masave për respektim të sistemit të administrimit të drejtë të drejtësisë nuk nënkupton automatikisht përgjegjësi penale për veprimet e gjyqtarëve të tjerë, të cilët për më tepër janë të pavarur në vendim-marrjen e tyre. Pa praninë e provave të cilat e lidhin të pandehurin N.U. me të pandehurit O.J., S.M., S.S. dhe T.M., kolegji duhet të konkludojë se i pandehuri N.U. nuk është fajtor as për nxitje të personit tjetër për të nxjerrë vendim të kundërligjshëm gjyqësor as për nxjerrje të vendimit të kundërligjshëm gjyqësor, në bashkëkryerje.

Si konkluzion, kolegji e shfajëson të pandehurin N.U. për Pikën 3.

Ankesa e mbrojtjes pranohet.

I. Vendimi mbi sanksionin penal

Mbrojtja e kundërshton vërtetimin e dënimeve, duke e konsideruar vendimin në fjalë si të padrejtë dhe si të kundërligjshëm. Prokuroria konsideron se dënimet e shqiptuara janë tejet të buta.

Në bazë të nenit 370, par. 8 të KPP-së, Gjykata Themelore i ka marrë parasysh të gjithë faktorët e rëndësishëm dhe të nevojshëm për caktimin e dënimit adekuat në paragrafët 386 – 406, 410 – 411, 416 – 421, 424 – 425, 428 – 429 dhe 432 të aktgjyqimit të kundërshtuar. Kolegji pajtohet në tërësi me analizën në fjalë. Gjykata Themelore në mënyrë të drejtë i ka vlerësuar dhe i ka matur të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe ka ardhur gjer tek dënimet proporcionale. As mbrojtja, as prokuroria nuk kanë përmendur asnjë rrethanë të re, e cila tashmë nuk është marrë në konsideratë nga Gjykata Themelore. Kolegji, për këtë arsye, i refuzon parashtresat e mbrojtjes dhe të prokurorisë.

Megjithatë, siç është parashtruar nga mbrojtja dhe nga prokuroria, kolegji e vëren se dënimi plotësues i shqiptuar nga Gjykata Themelore është i përkufizuar në mënyrë shumë të paqartë dhe për këtë arsye, kolegji e ndryshon këtë dënim si dënim plotësues të ndalimit të ushtrimit të profesionit, aktivitetit apo detyrës gjyqësore për një periudhë kohore prej dy (2) vjetësh, i cili iu shqiptohet të pandehurve O.J., S.M., S.S., T.M. dhe H.B., duke filluar nga dita kur aktgjykimi të marrë formën e prerë.

Ankesat përkatëse të mbrojtjes dhe të prokurorisë pranohen në mënyrë të pjesshme.

J. Vërejtjet përfundimtare

Gjykata e Apelit ka vendosur në mënyrë unanime sa i përket lirimit të të pandehurve N.U., E.A., F.B., R.R. dhe G.G., ndërsa me shumicë votash sa i përket shpalljes fajtorë si dhe dënimit të të pandehurve H.B., O.J., S.M., S.S. dhe T.M..

Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim është përfunduar më 16 maj 2016.

Kryetari i kolegjit,

Radostin Petrov
Gjyqtar i EULEX-it

Anëtari i kolegjit,

Xhevdet Abazi
Gjyqtar kosovar

Anëtari i kolegjit,

Roman Raab
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës,

Alan Vasak
Zyrtar ligjor i EULEX-it

Gjykata e Apelit
Prishtinë

PAKR 158/15

5 prill 2016